

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit BSc në “Fizioterapi”

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dhimitraq Stratobërdha.



Prof As. Irena Saço Kola.



(Shtator/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc Fizioterapi

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekesore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 199, datë 16.05.2012.
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Ba nr.30 datë 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor ne "Fizioterapi"
6	Cikli i studimit:	I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2011-2012
17	Studentë	152

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi

Programi i Studimit në Fizioterapi, Universiteti Privat “Albanian University” është hapur si program Bachelor, bazuar në Urdhërin e MASH Nr. 199, datë 16.05.2012. Sipas pikës 4 të këtij urdhëri, program i studimit fillon në vitin akademik 2011-2012.

Programi i Studimit në Bsc Fizioterapi, si cikël i parë studimi realizohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në tre vite akademike, me kohë të plotë, gjithësej 180 ECTS.

Programi i studimit iu drejtohet kandidatëve që zotërojnë titullin e maturës i njohur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë. Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2011-2012 dhe viti akademik 2013-2014 përkon me diplomimin e brezit të parë të studentëve. Programi i studimit është projektuar për të ofruar një formim të specializuar me qëllim përgatitjen e specialistëve në këtë disiplinë shkencore.

Studentët e programit të studimit Bsc Fizioterapi duhet të fitojnë aftësi për të vlersuar problematika të ndryshme të lidhura me rehabilitimin, planifikimin, organizmin, vlerësimin e asistencës; integrimi në punën në ekip e bashkëpunimin me figurat e tjera profesionale të përfshira në proceset e fizioterapise.

Ky program u akreditua me kusht në përfundim të vitit akademik 2015-2016, me Vendim Nr. 150, datë 31.03.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Urdhërit të MASH nr. 238 datë 09.05.2016. Pas një viti akademik 2016-2017, Institucioni Albanian University dorëzoi dokumentacionin për procedurën Follow-up për heqjen e kushteve të akreditimit të këtij programi me shkresën Nr. 370/1 Prot, dt 03.11.2016.

Pas vizitës në Institucion në Prill 2017, të një GVJ, që vlerësoi plotësimin e kushteve të vëna për këtë program, Bordi i Akreditimit vendosi me Vendim nr.30 datë 19.05.2017, Akreditimin e Programit të Studimit Bachelor në “Fizioterapi” të AU me kohëzgjatje për 2 (dy) vite akademike.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dhimitraq Stratobërdha dhe Prof As. Irena Saço Kola, si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako. Draft-Raporti i Vlerësimit të jashtëm është dërguar në Institucion më datë 16.09.2019 me anë të sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.128/46 prot. datë 16.09.2019. Institucioni ka sjellë me anë të sistemit AMS date 20.09.2019 dhe shkresës nr. 461/1 datë 23.09.2019, komentet mbi draft raportin.

GVJ, pasi u njoh me komentet e institucionit mbi Draft-Raportin e vlerësimit për programin e studimit në fjalë, sqaron si më poshtë:

Per komentin: “Albanian University informohet rregullisht mbi të regjistruarit në programin Bachelor në “Fizioterapi” në Institucionet simotra, pasi mbi ato të dhëna, si dhe informacione shtesë të marra dhe nga Urdhri Profesional Përkates, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë harton “Studimin e Tregut” në mënyrë periodike. Grupi i ngritur ad’hoc për këtë qëllim nuk e ka konsideruar të arsyeshme dhe etike, që të paraqesë në studim, të dhënat mbi numrin e të regjistruarve në programet në Institucionet të tjera, por nga ana tjetër padyshim që informohet dhe merr parasysh të dhënat.”. **Raporti në këtë pike ndryshon dhe ky ndryshim është paraqitur në kapitullin përkates.**

Per komentin: “Albanian Univesity, dëshiron të saktësojë që përshkrimet dhe funksionet e organeve të sipërpërmendura nuk janë në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe me organizimin Institucional aktual të AU. AU është organizuar dhe funksionon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, e reflektuar kjo në aktet e brendshme normative.” GVJ: **Raporti në këtë pike ndryshon dhe ky ndryshim është paraqitur në kapitullin përkatës.**

Per komentin: “Referuar akteve ligjore në fuqi, ngarkesa e programit të studimit mbulohet 74.2% nga staf akademik efektiv (me kohë të plotë). Sa i përket numrit të pedagogëve të brendshëm në raport me numrin total të pedagogëve, ky nuk është detyrim ligjor, sipas legjislacionit në fuqi”. **Raporti në këtë pike nuk ndryshon dhe** GVJ vlereson dhe e paraqet ne vleresimin sipas standarteve se Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë (PAE) aktual duket se si numer ka ardhur duke u rritur edhe pse nuk përbën mbi 70 % të personelit akademik të programeve të studimeve të ciklit të parë “Fizioterapi”, ai rezlizon 74.2% te ngarkese mesimore ne perputhje me ligjet ne fuqi.


ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E KONSTATIMEVE NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Konstatimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Plotësimi i stafit të departamentit me pedagogë specialist të fushës fizioterapisë me tituj e grada shkencore.
- b) Përmirësimi i raportit PAE me PAK sipas standardeve të përcaktuara ligjore.
- c) Plotësimi me standardet e kërkuara të stafit ndihmës mësimor shkencor e administrative.
- d) Pasurimi me tituj të rinj i Bibliotekës dhe specifikisht për fushën e fizioterapisë.
- e) Përmirësimi i nivelit të studentëve të rekrutuar.
- f) Ngritja e një strategjie të kërkimit shkencor dhe përmirësimi i cilësisë tij.
- g) Përmirësimi i moshës mesatare të stafit me tituj e grada shkencore dhe promovimi i karrierës akademike të stafit të brendëshëm.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për konstatimin a: institucioni ka plotësuar gradualisht stafin e departamentit me pedagogë specialist të fushës së fizioterapisë me tituj e grada shkencore. Nga 5 të tillë që kishte më parë, për këtë vit akademik, ka 8 PAE me tituj e grada shkencore. (2 Prof dhe 6 Dr)
- b) Për konstatimin b: institucioni ka ardhur në nivelin e duhur në raportet PAE/PAK. Raporti është përmirësuar dhe referuar sasisë së orëve në program, PAE mbulojnë mbi 74% të tyre.
- c) Për konstatimin c: institucioni ka plotësuar në vazhdimësi stafin ndihmës mësimor e administrativ. Nga 2 staf administrativ, për këtë vit ata janë shtuar si numër në 8 persona.
- d) Për konstatimin d: pasurimi me tituj të rinj i Bibliotekës dhe specifikisht për fushën e fizioterapisë është plotësuar. Është e evidente përpjekja dhe financimi për sigurimin dhe sjelljen e botimeve të fundit Elsevier për fizioterapinë.
- e) Për konstatimin e: mesatarja e studentëve të rekrutuar ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Nga 6.77 vjet në 7.23 për këtë vit akademik.
- f) Për konstatimin f: akoma ceshtja e kërkimit shkencor bëhet me hapa të ngadalshme.
- g) Për konstatimin g: ka ndryshime në moshën mesatare të stafit me tituj/grada shkencore. Vetëm 15.3 % janë të moshës mbi 55 vjec. Pjesa tjetër e stafit akademik janë poshtë moshës 45 vjec.



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit në Bsc Fizioterapi ka si qëllim formimin e Fizioterapistit, me objektivin final që i diplomuari të jetë në gjendje të njohë bazat shkencore dhe përgatitjen teoriko – praktike të nevojshme për të kuptuar fenomenet biologjike dhe ato të trashëguara, mekanizmat kryesore të funksionimit të organeve dhe aparateve, aspektet sociale, evoluimin e profesionit, koncepteve kryesore të rehabilitimit dhe të metodologjive të proceseve dhe të asistencës së personave, principet deontologjike, juridike, mjeksore dhe ligjore të profesionit, vlerësimi në menyrë kritike të aspekteve klinike, edukative, sociale dhe etike të përfshira në parandalim, në asistencë, në rehabilitimin, etj.

Objektivat e vendosura i përgjigjen misionit, që ka marrë përsipër Universiteti dhe realizohen në bazë të një strategjie të përcaktuar nga organet drejtuese të njësisë.

Programi i studimit është projektuar dhe zhvilluar për të përmbushur nevojat e tregut shqiptar me figura profesionale të afta për të punuar në sistemin shëndetësorë shqiptar dhe për ta menaxhuar atë, në gjendje për tu përballur me realitetin tonë dhe për ta përmirësuar atë. Në këtë kuadër, programi është hartuar dhe në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Universitetit, duke kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë shqiptar me një arsimim cilësor universitar dhe pasuniversitar në fusha të ndryshme profesionale, edukimin me vlerat më të mira morale dhe zhvillimin e kërkimit shkencor duke siguruar në këtë mënyrë praninë e specialistëve të aftë profesionalisht dhe të pastër moralisht në gjendje për të çuar përpara procesin e zhvillimit të sistemit shëndetësorë e shoqëror në Shqipëri.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Duke analizuar misionin, qëllimin dhe objektivat e institucionit, shprehur edhe në statut e rregullore të dokumentuara këto, del qartë, që programi Bsc në Fizioterapi është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin që ka AU, për të dhënë kontributin e vet në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë, edukimin e vlerave më të mira profesionale e morale, pasqyrë e të cilave do të jenë të diplomuarit në fushën e fizioterapisë.
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Kurrikula në tërësi, syllabuset dhe programet, objektivat e vendosura shprehin synimin për të pajisur studentët, si teorikisht dhe praktikisht, me njohuritë, aftësitë dhe kompetencën profesionale të nevojshme për profilin e fizioterapisë. Gjatë studimeve studentet pajisen me njohuri bazë, si përbërja e trupit, mënyra e funksionimit të sistemeve të ndryshme të organizmit tonë dhe patologjitë e ndryshme, duke kombinuar këto me metodat, mënyrat e mjetet e trajtimit fizioterapeutik dhe rehabilitimit, dhe duke përfshirë problematikën e shumë patologjive dhe në përputhje me cdo moshë. Synohet tek metodologjia dhe teknologjia bashkëkohore.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Nga takimet me drejtues të AU, e studentë që ishin të interesuar për

<p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>punësimin tek kolegët e tyre, u informuam që njohuritë dhe aftësitë e tyre, të fituar nga programi i studimit ishin në përputhje me ato cka kërkoheshin në tregun e punës.</p> <p>Programi BSc në Fizioterapi është hapur dhe hartuar për t'iu përshtatur zhvillimit ekonomik të vendit. Hartimi i tij u iniciua dhe implementua në përgjigje të një nevoje të shoqërisë në kushtet e reja, kur krahas sektorit publik shëndetësor kemi edhe atë privat qoftë ky spitalor, qoftë ambulator e pse jo deri tek qendrat fizioterapeutike e estetike, ku kërkohen metoda e mjete bashkëkohore rehabilituese e rekuperuese nga individë e grupe të caktuara në nevojë për fizioterapi e rehabilitim.</p>
---	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit është përshtatur me strategjinë për zhvillim dhe objektivat afatmesme e afatgjata të Universitetit; për të pasur një kurrikul sa më bashkëkohore dhe duke bërë marrëveshje bashkëpunuese me Institucionet shëndetësore e arsimore të tjera.</p> <p>Referuar moduleve, syllabuseve e përmbajtjes së cdo lënde që zhvillohet në ciklin e parë shikohet synimi për pajisjen e studentëve me koncepte themelore, njohuri e parime bazë, të cilat trajtohen në mënyrë shkencore duke u mbështetur dhe garantuar nga pedagogët e institucionit.</p> <p>Programet sipas viteve e sidomos në vitet e 2-të e 3-të japin njohuri, koncepte dhe synojnë të formojnë shprehje praktike të veçanta e të ngushta, për çdo sistem dhe sëmundje, çka shkon me misionin dhe qëllimin e institucionit, që të formojnë specialistë jo thjeshtë të përgjithshëm por edhe të përballojnë nevojat e specialiteteve të ndryshme mjekësore për fizioterapi e rehabilitim.</p>
---	--

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Hartimi dhe hapja e programit Bsc Fizioterapi është bërë me synimin e qartë të plotësimin të nevojave që ka tregu i punës në vendin tonë, ku zhvillimet e viteve të fundit kanë nxjerrë më në pah nevojën për specialistë Fizioterapie e Rehabilitimi.</p> <ol style="list-style-type: none"> Studimet e mirëfillta të tregut të punës në Shqipëri kanë qenë të limituara nga ana e AU. Por gjatë Qershorit 2017 Departamenti Infermierisë e Fizioterapisë ka një studim më të detajuar të tregut të punës, cka ka vlejtur për përmirësimin e programit të fizioterapisë dhe ofrimin e tij në përputhje me kërkesat e punësimit në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Nga Institucioni bëhen përpjekje për të siguruar kërkesa nga subjekte të ndryshëm për nevojat e tyre për punësim të specialistëve të fizioterapisë e rehabilitimit. Kërkesat dhe numri i studentëve ka ardhur në rritje cdo vit. Ka informacion për të regjistruarit në programet në institucione simotra.
---	---

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave

kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;	Programet, duke iu referuar çdo moduli apo lënde nuk bien ndesh me interesat tona kombëtare, madje i mbështet ato nëpërmjet sigurimit të një cilësie jete më të mirë të individëve apo komunitetit.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Nga këndvështrimi i traditave kulturore kombëtare, në këtë fushë, programi i ofruar nga AU, për fizioterapi, ka një përshtatje dhe mbështetje shkencore e bashkëkohore të traditës krijuar në vendin tonë.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Duke u njohur me misionin dhe qëllimin e institucionit, shprehur edhe në rregullore, marrëveshje dhe objektiva të dokumentuara rezultojnë, që programi BSc në Fizioterapi është përgatitur në përputhje me misionin dhe qëllimin, që ka AU.</p> <p>Kurrikula në tërësi, syllabet dhe programet, objektivat e vendosura në to synojnë të pajisin studentët, si teorikisht dhe praktikisht, me njohuritë, aftësitë dhe kompetencën profesionale të nevojshme.</p> <p>Programi Bsc në Fizioterapi i është përshtatur zhvillimit ekonomik të vendit. Kërkesat dhe numri i studentëve kanë ardhur në rritje çdo vit. Ka informacion për të regjistruarit në programet në institucione simotra.</p> <p>Albanian University me strukturat e veta ka hulumtuar në tregun dinamik të këtij specialiteti, cka shërben edhe për këshillim të karrierës së të diplomuarve.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, pjesë e të cilit është Departamenti përgjegjës i programit, ai i Infermierisë dhe Fizioterapisë, ka në përbërje të vetë edhe Departamentin e Stomatologjisë dhe atë të Farmacisë. Fakulteti dhe cdo njësi kanë organet e tyre drejtuese dhe administrative (Dekani, Përgjegjësit e Departamenteve, etj).

Personeli akademik është i përbërë nga pedagogë me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesëshme dhe personel akademik të ftuar. Struktura dhe kompetencat janë përcaktuar në Statutin e Rregulloret si institucion dhe njësi.

Tabela 1 në aneks jep një pasqyre të qartë të strukturës, përbërjes dhe nivelit të personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Viti akademik 2018-2019.

Kurse në **Tabelen 2** në aneks pasqyrohen të detajuara këto të dhëna për Departamentin e Infermierisë e Fizioterapisë dhe **Tabela 3** në aneks jep të dhënat për Programin Bachelor Fizioterapi. 2018-19.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit
- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

AU është organizuar dhe funksionon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, e reflektuar kjo në aktet e brendshme normative.

Senati akademik është struktura më e lartë drejtuese dhe vendimmarrëse e Universitetit. Senati ushtron kompetencat që lidhen me planifikimin, programimin dhe koordinimin e procesit mësimor dhe të kërkimit

shkencor. Senati akademik merr vendime mbi strategjitë e zhvillimit të universitetit, drejton dhe kontrollon veprimtaritë mbi cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe vlerëson nivelin e tyre.

Bordi administrativ është organi drejtues administrativ më i lartë, me kompetenca vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse mbi veprimtarinë e ekonomiko-financiare të Universitetit.

Rektori është funksionari drejtues akademik më i lartë. Ai përfaqëson Universitetin duke vepruar në emër dhe për llogari të tij në marrëdhëniet me Ministrinë e Arsimit Sporteve dhe Rinisë (MASR) dhe institucione të tjera të administratës publike, në marrëdhëniet me jashtë dhe me institucione të tjera homologe.

Detyrat dhe kompetencat si të drejtuesve edhe personelit tjetër parashikohen në Statutin e Universitetit, në Rregulloren e tij dhe në Rregulloret e tjera të veçanta.

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC) realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së aktivitetit akademik, duke bashkëpunuar me ASCAL në përputhje me dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri. (ZSBC) është përgjegjëse për proceset e akreditimit, rankimit dhe çdo procedurë tjetër të vlerësimit të zhvillimit të aktivitetit akademik të Universitetit.

Kryerja e vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit bëhet çdo 3 vite akademike.

Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës mbikëqyr, promovon dhe orienton përmirësimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës ka detyrimin të japë në çdo rast mendime dhe rekomandime me shkrim gjatë mbledhjeve të Senatit Akademik dhe Këshillave të Fakulteteve ku merren në shqyrtim çështje të kurrikulave. Kjo zyrë bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me njësitë bazë të Universitetit, si dhe me ZSBC. Ajo kryen në vijimësi studime të thelluara mbi modelet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare mbi kurrikulat.

Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës kontrollon dhe është përgjegjëse për koordinimin dhe vlerësimin semestral të programeve mësimore, jep mendime me shkrim për aplikimin e programeve të reja studimore ose ndryshimin e tyre, si dhe merr, asiston në procesin e rekrutimit dhe të punësimit të stafit akademik, duke dhënë rekomandimet përkatëse për kriteret e tyre sipas lëndëve.

Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës vepron nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit i cili miraton përshkrimin e punës së kësaj zyre dhe e paraqet për miratim në Senatin Akademik.

Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës raporton në mënyrë periodike pranë Rektorit mbi gjendjen e kurrikulave dhe përmirësimin e tyre, si dhe paraqet një raport çdo vit akademik për këtë çështje.

Asambleja e personelit akademik përbëhet nga anëtarë të stafit akademik. Mënyra e funksionimit, përbërja dhe çështje të tjera organizative dhe vendimmarrëse përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Dekani është funksionari më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Dekani emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Senati Akademik për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi. Dekani duhet të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose gradën shkencore 'Doktor' të fituar pranë universiteteve perëndimore.

Dekani i Fakultetit drejton, kontrollon, organizon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në Fakultet.

Kompetencat e Dekanit, marrëdhëniet e tij me strukturat e tjera në nivel Fakulteti parashikohen në Rregulloren e Fakultetit.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet. Ai ka për detyrë të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Qendra Kërkimore - Shkencore (QKSh) është njësi bazë me strukturë të ngjashme dhe të barazvlefshme me departamentin, fusha e kërkimit të së cilës harmonizohet me interesat e departamenteve të fakultetit.

Qendrat bashkërendojnë planin e punës shkencore me departamentet e fakultetit, kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë.

Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me njësitë bazë, përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Përgjegjësi i departamentit në Fakultet është funksionari më i lartë drejtues i njësisë bazë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton dekanit. Përgjegjësi i departamentit propozohet nga Senati akademik dhe emërohet nga Administratori me një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Te dhënat janë paraqitur në anekse. Është bërë edhe azhurnimi me të dhënat që morrëm nga vizita në vend në momentin e vlerësimit të jashtëm.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student dhe kriteret e rekrutimit të personelit akademik, do të jepen të detajuara në vlerësimin e treguesve të matshëm.

Sa i takon ceshtjes së ngarkesës mësimore të stafit duke iu referuar zbatimit të Udhëzimit nr. 29 dt. 10.09.2018 të MASR vërehet një zbatim korekt i këtij udhëzimi.

Nga përllogaritjet del se 74.2 % te oreve që përmban programi mbulohen nga PAE dhe vetem 23.8 % nga PAK. Po kështu në zbatim të këtij udhëzimi nuk ka pedagog që të japi më shumë se 3 lëndë apo të jetë titullar i më shumë lëndëve, gjë që duket edhe nga Syllabet ku janë të vendosur pedagogët dhe titullarët e lëndëve.

Ngarkesa mësimore është e përllogaritur për të gjithë kategoritë e stafit efektiv apo me kohë jo të plotë në përputhje me Paragrafin II, pikat 1 dhe 2 të udhëzimit Nr 29, dt 10.09.2018 të MASR duke iu përmbajtur edhe orëve suplementare apo aktivizimin në veprimtari të tjera.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Ka një raport 26 PAE / 14 PAK. Po kështu personeli akademik dhe administrativ nga këndveshtrimi kualifikimit është në nivelin e duhur.

Shiko Tabelën 3 në Aneks

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre.

Personeli akademik dhe administrativ, për programin Bachelor në Fizioterapi, nga këndveshtrimi kualifikimit është në nivelin e duhur. PAE janë 2 Prof, 5 Dr dhe pjesa tjetër SPA dhe Msc.

Shiko tabela 3 dhe 3/1 në Aneks

- Të dhënat sipas seksit

Nga PAE 6 pedagogë janë meshkuj,(nga të cilët 1 Prof, 1 PhD, dhe të tjerët Msc)

Nga PAE 20 janë femra (pedagogë apo personel mbështetës) 1 Prof, 4 Dr dhe të tjerët Msc.

Shiko tabela 3 në Aneks

- Të dhëna sipas moshës së personelit.

Nga PAE 1 Prof është me moshë mbi 65 vjec, 1 Prof 55-65 vjec kurse Dr dhe ata me Msc janë poshte moshës 45 vjec dhe shumica e tyre poshtë 35 vjec.

Shiko tabela 4 dhe 4/1 në Aneks

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

U panë gjatë vizitës disa kontrata, që u zgjodhën në mënyrë të rastësishme, për pedagogë efektivë dhe me kontratë dhe ato ishin ndërtuar bazuar në Ligjin Nr 80/2015 e bazuar në Kodin e Punës.

Për pedagogët efektivë të kategorive profesor/lektor/as.lektor janë me afat të pacaktuar.

Kontratat për stafin akademik me kohe të pjesëshme profesorë/lektor janë me afat të pacaktuar, kurse për kategoritë as.lektor janë me afat të caktuar.

Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kontrata e Punës, Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Fakultetit dhe rregullorja e Departamentit përkatës që ofron programin.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Raporti personel akademik/ndihm-akademik mësimor/ndihm-akademik administrativ/studentë, për këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 është në shifrat **40/0/3/273**

Kurse raporti PAE/PAK për këtë program është 26/14.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Nga takimi me drejtues të institucionit, stafin akademik dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore vërehet synimi për ndjekjen e procedurave korrekte ligjore e transparente të rekrutimit. Institucioni ka përcaktuar qartë kriteret, procedurën dhe modalitete të tjera për përzgjedhjen e stafit akademik. Zyra e Burimeve Njerezore mban një bazë të dhënash, me ndryshimet që ndodhin në cdo kohë
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë (PAE) aktual duket se si numer ka ardhur duke u rritur edhe pse nuk përbën mbi 70 % të personelit akademik të programeve të studimeve të ciklit të parë "Fizioterapi", ai rezlizon 74.2% te ngarkese mesimore ne perputhje me ligjet ne fuqi. Vetë tabelat e RVB japin të dhëna se ku punojnë full-time pedagogët. Janë përcaktuar procedura dhe janë ngarkuar komisione edhe persona përgjegjës për mënyrat e vlerësimit të personelit, duke përfshirë edhe
Kriteri 3 Institucioni ndjek	

<p>procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>vlerësimin nga studentët nëpërmjet pyetësorëve përpara provimeve, për cdo pedagog.</p> <p>Këto procedura përfshijnë të gjitha aspektet karakterizuese të saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi nga drejtuesit e departamenteve - Vlerësimi nga studentët - Vlerësimi nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë <p>Zyra e Burimeve Njerezore mban një bazë të dhënash, me ndryshimet që ndodhin, të njoftimeve për punë, etj</p>
---	--

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Për të gjithë stafin akademik dhe administrativ disponohet dokumentacion; me CV, nivelin e kualifikimit dhe aktivitetin akademik-shkencor si për PAE dhe për PAK.</p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ; Kjo listë u vu në dispozicionin e GVJ dhe pasqyrore emrat e pedagogëve, lëndët apo modulet që mbulon, ngarkesën mësimore të tyre, etj.</p> <p>Universiteti mbledh dosjet e aplikantëve të cilat më pas përzgjidhen nga departamentet përkatëse në bazë të kualifikimeve të secilit aplikant. Universiteti ndër vite ka patur e ndjekur një politikë rekrutimi që ka ardhur duke u përmirësuar. Pedagogë të ndryshëm aplikojnë në periudhat Korrik - Gusht me kërkesat për lëndët që mund të zhvillojnë, por ka patur edhe rekrutime ndërmjet semestrave duke iu referuar semestrit kur ofrohet lënda.</p> <p>Pedagogët e përzgjedhur përfaqësojnë nivel të kënaqshëm profesional, akademik e shkencor në fushën e fizioterapisë e rehabilitimit. Për drejtimet kryesore të programit ishin përzgjedhur ata me përvojë, grada shkencore e tituj akademikë Prof. e Dr. Nëse në fillimet e programit disa vite më parë përqindja më e madhe ishin me Master Shkencor, ka përmirësime dhe synohet në të ardhmen për kualifikim e ndryshim pozitiv në favor të afrimit të pedagogëve me tituj e grada shkencore.</p>
---	--

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin,</p>	<p>U konstatua një angazhim optimal i personelit ndihmës mësimor-shkencor për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera që i shërbenin programit, në vecanti për Kabinetin e Fizioterapisë, ku kujdesi për kabinetet, e aparaturat ishin të veçanta.</p> <p>Personeli, të gjithë burimet njerzore ishin të angazhuar dhe me disiplinë, po ashtu përfaqësonin nivel profesional, duke krijuar kështu mundësinë për përmbushjen e objektivave të programit.</p> <p>Kabineti i Fizioterapisë brenda kampusit mundësonte kushte optimale për praktikat profesionale, me staf të kualifikuar e të mjaftueshëm që ndiqnin e drejtonin studentët. Po kështu me marrveshje me Qendrën spitalore dhe Agjensinë e shërbimeve sportive realizoheshin edhe ato praktika që duhen kryer në klinika ku drejtoheshin nga staf i kualifikuar. Vetë numri i kufizuar i studentëve në kurse favorizonte mundësin e tutorimit, duke përmbushur kriterin në fjalë dhe zbatuar VKM nr. 418, dt. 10.05.2017.</p>
--	---

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;	Departamenti i Infermierisë dhe Fiziotherapisë momentalisht nuk ofron një program të tillë. Ai organizon gjatë një viti akademik simpoziume ose konferenca shkencore me pjesëmarrjen e personelit akademik që zhvillon mësim pranë këtij departamenti.
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.	Një nga objektivat e ardhshëm të departamentit është kualifikimi i mëtejshëm i personelit akademik. Institucioni disponon të dhënat, statistikën në vite, të personelit akademik, të dhënat e studentëve, plan-programet dhe syllabuset përkatës.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë (PAE) aktual duket se nuk përbën mbi 70 % të personelit akademik të programeve të studimeve të ciklit të parë Bsc Fizioterapi. Megjithatë është fakt që PAE mbulon dhe zhvillon 74.2 % të orëve që përmban programi.</p> <p>Ka ndryshim ndër vite për rekrutim të personelit akademik me tituj e grada shkencore dhe për kualifikim e ndryshim pozitiv në numrat e raportet PAE/PAK.</p> <p>Universitetit duhet të marrë masat e domosdoshme për mbështetjen e stafit akademik në kualifikimin e mëtejshëm.</p>	

4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit.**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Në shërbim të programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, edhe programeve të tjera të ofruara nga Departamenti i Infermierisë dhe Fiziotherapisë, është vënë në dispozicion, e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj një ndërtesë e madhe, e përshtatshme për studentët me klasa dhe laboratorë për secilin nga programet e studimit. Universiteti dispononte klasa me hapësira të kënaqshme, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Në fondin e bibliotekës numërohen rreth 6000 libra që u përkasin titujve të ndryshëm jo specifikë për këtë program studimi.

Por përsa i përket teksteve profesionale të Fiziotherapisë mungesat në vite kanë filluar të përmirsohen ndjeshëm nëpërmjet tërheqjes së literaturës më të fundit dhe cilësore të fushës së fiziotherapisë (botime Elsevier). Mjafton të kujtojmë që në fillime të programit ka patur vetëm 5 të tillë, nga të cilët 3 kanë qenë traktate të përgatitur nga vetë institucioni nëpërmjet pedagogëve.

Biblioteka on line është një tjetër veçori e infrastrukturës universitare të këtij Institucioni. Gjatë vizitës në vend, na u shpjegua se si funksiononte kjo bibliotekë.

Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore punonte me orar të zgjatur, nga ora 08⁰⁰ deri në orën 19⁰⁰. Ky orar është i shpallur në mjediset e saj. Për çdo student kishte kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës, si dhe sistem të kompjuterizuar të shërbimit bibliotekar. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar. Kjo detyrë

dhe programi i menaxhimit të saj është hartuar nga vetë studentët e institucionit, si pjesë e detyrave të kursit dhe e prezantimeve të tyre në konferenca shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Tabela 5 në Aneks jep një pasqyrë të detajuar mbi mjediset që disponon AU në shërbim të programeve dhe për Fakultetin e Shkencave Mjekësore ku përfshihet edhe programi Bachelor Fizioterapi.

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Institucioni ka edhe bibliotekën me tituj librash e periodikësh, bashkëkohorë dhe në shërbim të programeve të universitetit, për lëndët e përgjithshme, por janë shtuar edhe ato profesionale, fizioterapie. Ka tashmë tekste mjekësore për realizimin e programit e moduleve të ndryshme, mjaftueshëm e që ndihmojnë studentin për formimin e tij.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Shërbimi i librarisë elektronike në mbështetje të kërkimit të periodikëve online nuk u ofrohet studentëve. (periodikë të lidhur me Fizioterapinë). Literatura e përdorur nga pedagogët është jo vetëm ajo e përcaktuar që në fillim të vitit si teksti shkollor lëndor bazë, por edhe burimet e tjera shtesë

<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>si revista, interneti, etj. Staf i pedagogjik i AU së bashku me punonjëset e shërbimit të bibliotekës planifikojnë, e kërkojnë shtimin e zërave të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore punon nga ora 8.00 deri në orën 19.00 Ky orar është i shpallur në mjediset e saj.</p>
---	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Institucioni që nga hapja e programit ka në zotërim një ndërtesë moderne, të pajisur me salla leksionesh,seminarësh, konferencash, laboratorësh të informatikës të nevojshëm për realizimin e programit të studimit. Programi i studimit ofrohet në godinën e përcaktuar më sipër, ndërkohë që zhvillimi i praktikave profesionale në institucione të tjera menaxhohet dhe kontrollohet vazhdimisht për arritjen e rezultateve të përcaktuara në programin e studimit.</p> <p>Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura cilësisht për realizimin e programit të studimit Të gjitha mjediset që disponon Albanian University janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Për realizimin e programit të Fizioterapisë është e nevojshme pasja e një laboratorit fizioterapie i cili i është vënë në dispozicion studentëve prej dy vitesh me të gjitha pajisjet siç janë manekina, mjete të nevojshme për të simuluar sallën e një praktike etj.</p> <p>Bie në sy investimi për aparaturën moderne TECAR, etj.</p> <p>Institucioni në varësi të programeve që ofron ka të paktën një laborator, në rastin e programit të studimit në fizioterapi ka në dispozicion një laborator infermierie dhe një për programin e fizioterapisë.</p> <p>Institucioni disponon laboratorë të kompletuar për të gjitha programet e studimit.</p> <p>Praktikat profesionale janë praktika që në rastin e programit të studimit Bsc Fizioterapi zhvillohen në laborator dhe në spital ne qytetin e Tiranës, sikundër edhe në Agjencinë e të tjera me të cilat AU ka marrveshje.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Albanian University disponon të gjitha kushtet e mundshme për një mbarëvajtje cilësore të procesit mësimor. Numri i sallave për leksione dhe seminare, bashkuar me laboratorët, ofrojnë tek studenti mundësi të gjera për përfitimin e dijeve.

Hapësirat e tjera të godinës janë ideuar për një përdorim multi-funksional. Salla e Konferencave, kupola apo hollet, në varësi të situatave të ndryshme që ofrohen, mund të përdoren për aktivitete promovuese, por edhe si laboratorë për praktikat lëndore.

Institucioni ka edhe bibliotekën me tituj librash e periodikësh, bashkëkohorë në shërbim të programeve të universitetit, për lëndet e përgjithshme formuese e baze, tashmë mjaftueshem për ato profesionale, (fizioterapie)

Kalimi nga një ndertesë në tjetrën nga leksionet në praktika çon në humbje kohe e lodhje fizike dhe është për momentin një objektiv për tu rregulluar në të ardhmen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas drejtuesve të Institucionit: Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve.

Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhënat e detajuara jepen në **Aneks në Tabela 6 dhe 6/1**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje).

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare. Të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. 1/3 e këtyre burimeve të ardhurave shpenzohen për qiranë e objekteve dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj), dhe pjesa tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohen për pagat dhe sigurimet e stafit të punësuar (akademik dhe administrative), si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit. Kosto për student për këtë vit akademik në programin e Fizioterapisë Bachelor është 130000 lekë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
---------------------	-------------------------

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.

Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;

Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;

Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Institucioni bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik. Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke ju referuar bilancit).

Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet, aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Institucioni harton raportin e bilancit të të gjithë shoqërisë çdo vit në të cilin parashikohen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat, ky raport disponohet nga zyra e financave të universitetit.

Institucioni i ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit.

Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare e cila rritet nga viti në vit në saj të rritjes së numrit të studentëve dhe shtimit të programeve të studimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Konstatohet një organizim dhe mbajtje të rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Dokumentacioni i lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodikë të cilave u është nënshtruar institucioni.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC) realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së aktivitetit akademik, duke bashkëpunuar me ASCAL në përputhje me dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri.

ZSBC është përgjegjëse për proceset e akreditimit, rankimit dhe çdo procedurë tjetër të vlerësimit të zhvillimit të aktivitetit akademik te Universitetit.

Realizohen 2 anketime në vit me studentët, në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të atij të dytë, gjithënjë përpara fillimit të provimeve, nga ku merret edhe mendimi i studentëve për cilësinë e gjithëcka ofron AU gjatë kohës së studimit dhe që shërben për përmirësimin e punës në përputhje me nevojat e Arsimit të Lartë në vendin tonë. Kryerja e vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit bëhet çdo 3 vite akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Në AU sipas një rregulli tashmë prej vitesh realizohen 2 anketime në vit, në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të atij të dytë, gjithënjë përpara fillimit të provimeve. Gjatë vitit akademik 2018-2019 kanë marrë pjesë 38% të studentëve. Respektivisht në semestrin e parë 46% e studentëve dhe në semestrin e dytë 31% të studentëve. Rezultatet pas përpunimit të pyetsorve janë diskutuar në njësitë bazë dhe përcjellë në njësitë kryesore, e nga NJSBC në Rektorat. Mbi këtë bazë pas opinioneve e kërkesave të studentëve merren masa për përmirësim të mëtejshëm dhe plotësimin e kërkesave të shprehura nga studentët.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në Albanian University, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë ka funksionuar në nivel njësie bazë, pra departamenti. Kështu në nivel departamenti, me asistencën e Zyrës së Kurrikulave, para çdo fillim viti të ri akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen, programet mësimore, literatura dhe sistemet e vlerësimit.

Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të SBC nga sekretaria mësimore.

Kjo zyrë ka detyrim paraqitjen e një raporti vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë. Ky raport i paraqitet Rektorit, i cili më tej e përfshin atë në rendin e ditës së Senatit Akademik për diskutim.

ZSBC është e përbërë nga një grup pune. Kjo Zyrë harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton edhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat me tej iu shpërndahen Departamenteve dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve ose pedagogeve, ZSBC bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr problematikat kryesore, përmirësimet që duhen kryer me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, interveprimit të të gjithë faktorëve përbërës së Universitetit.

Në përfundim të semestrit dhe vitit akademik njësia bazë harton një raport vetëvlerësimi, ku përfshihen elementë të mësimdhënies, analizë e programeve, stafi i rekrutuar, kalueshmëria e studentëve dhe rezultatet e arritura, veprimtaria shkencore dhe nëpërmjet një analize SWOT ndihmon për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Tabela 7 në Anekse jep detajet për grupin e NjSBC, kohen dhe kualifikimin e tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni nëpërmjet ZSBC-së përdor instrumente matëse të standardizuara të detajuara në raportet semestrale dhe vjetore. Mësimdhënia është e një niveli shumë të mirë. Nga kontaktet me studentët, del se pedagogët përpiqen të jenë sa më pranë tyre, duke ndihmuar me punë individuale studentët me vështirësi në të kuptuar apo realizimin e detyrave të dhëna. Matja e cilësisë bëhet herë pas here nga shefi i departamentit që merr pjesë në orë mësimore të veçanta ose nga interpretimi i të dhënave që dalin prej provimeve të zhvilluara në mes të vitit apo detyrat e dorëzuara në lëndë të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p>	<p>Institucioni përfshin gjithmonë të dhënat e raporteve semestrale siç janë % e kalueshmërisë apo notat mesatare apo realizimin e objektivave në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për programin e Studimit.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>Institucioni në çdo raport vjetor, apo veprimtari publikon rezultatet e pritshme, dhe rezultatet që synon të arrijë.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p>	<p>Institucioni në çdo raport vjetor, apo veprimtari publikon rezultatet e pritshme, dhe rezultatet që synon të arrijë.</p>
<p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. 	<p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; pyetje konceptuale;</p> <p>Teste të standardizuara kombëtare</p> <p>Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët.</p> <p>Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës;</p> <p>Informacioni i marë është përdorur për hartimin e vlerësimit të brendshëm, është bërë transparent edhe për studentët dhe stafin akademik.</p>
<p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Albanian University, ka akredituar disa programe të ciklit të parë, të ciklit të integruar dhe programe të ciklit të dytë master profesional dhe shkencor.</p> <p>Institucioni për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka si udhëzues manualin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së bashku me standardet, miratuar nga ASCAL. AU kryen në mënyrë sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, si p.sh në formën e sondazheve apo organizimit të pyetësorëve në internet me të gjithë studentët.</p> <p>Institucioni ka një politikë të qartë dhe ndjek nëpërmjet NJSCB procedurën e vlerësimit periodik të veprimtarive për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programit të studimeve.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma formal për mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, siç janë kontrollet e ngarkesave, respektimi në praktik i materialeve të depozituara tek syllabuset dhe literatura e përdorur.</p> <p>Nga takimi me studentët rezultojnë se institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron me studentët, rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve sikurse edhe avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional. ka një informim të rregullt të studentëve dhe stafit, për rëndësinë e plotësimit të cilësisë dhe standardeve.</p> <p>Analiza për cilësinë zhvillohen kryesisht në përfundim të semestrit dhe të vitit akademik dhe në përfundim të tyre formulohen edhe politikat, strategjitë dhe masat përkatëse për përmirësimin e procesit akademik dhe të rezultateve të tij, dhe i raportohet strukturave të interesuara përkatëse. Ato janë shprehur edhe në strategjinë e zhvillimit institucional dhe dokumentet bazë të universitetit me të cilat punohet dhe operohet çdo ditë (si rregulloret e ndryshme, aktet normative të dala nga këto dokumente, vendimet e senatit, etj)</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë ka një politikë të qartë për sigurimin e cilësisë në të gjithë nivelet e shërbimit të universitetit. Vetë institucioni kryen në mënyrë sistematike vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, si p.sh në formën e sondazheve apo organizimit të pyetësorëve në internet me të gjithë studentët duke ruajtur anonimatit dhe duke përdorur përfundimet jo për të penalizuar pedagogët, por për të përmirësuar cilësinë e punës së tyre.

Rezultatet bëhen objekt i diskutimit në departament duke u vënë në dispozicion të të gjithë personelit akademik apo mbështetës për të reflektuar në funksion të rritjes së cilësisë.

Ndërkohë zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka marrë në mënyrë periodike trajnime nga ASCAL për standardet e sigurimit të cilësisë, të cilat i ka përcjellë edhe në universitet ku janë të shprehura në dokumentacionin bazë të universitetit si Statut, Rregullore, Udhëzime etj.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Programi i studimit bachelor në Fizioterapi, Universiteti Privat “Albanian University” është hapur sipas pikës 4 në Urdhërin e MASH Nr. 199, datë 16.05.2012, për të filluar në vitin akademik 2011-2012 dhe realizohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në tre vite akademike, me kohë të plotë, gjithësej 180 ECTS.

Programi i studimit iu drejtohet kandidatëve që zotërojnë titullin e maturës i njohur nga MASR. Programi i studimit është projektuar për të ofruar një formim të specializuar me qëllim përgatitjen e specialistëve në këtë disiplinë shkencore.

Sipas kurrikul-ës, referuar përmbajtjes, planit mësimor dhe elementëve të tjerë synohet që studentët e programit të studimit Bsc Fizioterapi të fitojnë aftësi të lidhura me rehabilitimin, planifikimin, organizimin, vlerësimin e asistencës; integrimi në punën në ekip e bashkëpunimin me figurat e tjera profesionale të përfshira në proceset e fizioterapise.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi.

Programi i Studimit në Fizioterapi , si cikël i parë studimi realizohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në tre vite akademike, me kohë të plotë, gjithësej 180 ECTS.

Programi i studimit iu drejtohet kandidatëve që zotërojnë titullin e maturës i njohur nga Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sportit. Ky program studimi ka filluar në vitin akademik 2011-2012 dhe viti akademik 2013-2014 përkon me diplomimin e brezit të parë të studentëve. Programi i studimit është projektuar për të ofruar një formim të specializuar me qëllim përgatitjen e specialistëve në këtë disiplinë shkencore.

Ky program u akreditua me kusht në përfundim të vitit akademik 2015-2016, me Vendim Nr. 150, datë 31.03.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Urdhërit të MASH nr. 238 datë 09.05.2016. Pas një viti akademik 2016-2017, Institucioni Albanian University dorëzoi dokumentacionin për procedurën Follow-up për heqjen e kushteve të akreditimit të këtij programi me shkresën Nr. 370/1 Prot, dt 03.11.2016.

Pas vizitës në Institucion në Prill 2017, të GVJ, që vlerësoi plotësimin e kushteve të vëna për këtë program, Bordi i Akreditimit vendosi me Vendim nr.30 datë 19.05.2017, Akreditimin e programit të studimit bachelor në “Fizioterapi” të AU me kohëzgjatje për 2 (dy) vite akademike.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë
Këto të dhëna jepen të detajuara në **Tabela në Aneks 8, 8/1 dhe 8/2 Tabela e Planit mësimor është e dhënë në aneks.**

Studentët e vitit të dytë dhe të tretë, pra të regjistruarit deri në vitin akademik 2017-2018 ndjekin programin e vjetër mësimor.

Kurse të regjistruarit aktualisht në vit të parë, pra në fillim të këtij viti akademik 2018-2019, ndjekin programin e rishikuar dhe përmirsuar, dhe miratuar nga MASR me shkresë Nr.4932/1, dt. 05.06.2018.

Në planin mësimor të paraqitur është zbatuar raporti ligjor i ngarkesës mësimore në auditor e jashtë auditorit, puna e pavarur e studentit gjatë vitit akademik. Të qarta janë edhe raportet e formave të mësimdhënies.

Përqindja e lëndëve A (17.2%) +B (52.7%) është 70% dhe përputhet me kërkesat e VKM Nr.41/2018, shtojca Nr.1.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Për leksionet	10 orë në auditor dhe	15 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	7.5 orë në auditor dhe	17.5orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Laboratorët	22.5 orë në auditor dhe	2.5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	25 orë në auditor dhe	0 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	25 orë në auditor dhe	0 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	0 orë në auditor dhe	25 orë punë e pavarur e studentit

Këto të dhëna jepen të detajuara **Tabela në Aneks 8/3**

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara.

Aktualisht në vitin e parë, pra në fillim të këtij viti akademik 2018-2019, studentët ndjekin programin e rishikuar dhe përmirsuar, dhe miratuar nga MASR me shkresë Nr.4932/1, dt. 05.06.2018. Pra është bërë një rishikim dhe ndryshim i programit por pa kaluar masën 20%

Shiko Tabelën 9 ne Aneks

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës.

Duke iu referuar planeve mësimore të programit të studimit të lidhura me personelin akademik përkatës kualifikimi i tyre dhe fusha e ekspertizës përputhet me lëndët që mbulojnë, nga ana tjetër ngarkesa e tyre është përcaktuar konform ligjeve e udhëzimeve në fuqi si nga numri i lëndëve që japin (jo më shumë se tre) edhe për ngarkesën apo llojin e mësimdhënies leksion apo seminar, laboratorë, praktikë.

Shiko Tabelën 10 ne Aneks

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabus-et janë hartuar sipas ligjeve në fuqi bazuar në e kërkesat e VKM Nr.41/2018, Ato permbajne: Emërtimin e lëndës/modulit, vitin/semestri kur zhvillohet lënda emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik. Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS. Syllabuset në dosjen e vetevlersimit janë të plotë dhe përmbajnë të gjithë elementët përbërës.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Referuar VKM Nr.41/2018, Shtojca Nr.2, syllabuset në dosje janë sjellë pa mungesa në elementët përbërës. Ato i përmbushin të gjitha pikat e Shtojcës nr. 2 të VKM Nr 41/2018. Vihet re një korrelim i mirë midis titujve të syllabuseve dhe përmbajtjes së tyre, si dhe përputhje e tyre me qëllimin dhe objektivat e programit studimor të propozuar. Në syllabuse dhe strukturën e stafit pedagogjik shihet mbulim i plotë i lëndëve me pedagogë të jashtëm e të brendshëm, me tituj akademik Doktor, Prof. Asoc, dhe Profesorë. Metodatat e mësimdhënies janë shprehur qartë në çdo syllabus dhe janë në përputhje me specifikat e secilës lëndë. Referuar "Rregullores së

Programit” dhe syllabuseve, për çdo lëndë shprehen qartë format e vlerësimit me përqindje vlerësuese sipas formës, provim i ndërmjetëm, provim final, vlerësime detyrash (detyrime), etj.

Bazuar tek plani mësimor dhe syllabuset rezulton se ky program është strukturuar për ti shërbyer studentëve për një formim sa më bashkëkohor, gjë që shihet edhe tek përmbajtja e programeve të lëndëve. Ka një përputhje të ngarkesës në auditor dhe jashtë tij të studentit, me pritshmëritë e programit. Përmbajtja e programit është e kuptueshme dhe e përballueshme për studentët. Të dhënat mbi planet mësimore, sipas tabelave të rekomanduara dhe të lidhura edhe me personelin akademik përkatës ishin po ato që pasqyrohen në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Institucioni ofron programe të studimeve të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); cka përkon edhe me Udhëzimin nr 15 të MASH ku cdo modul, lekson, seminar, laborator, praktikë është ekuivalentuar me ECTS.</p> <p>Kreditet e grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë janë 60 kredite; për 3 vjet 180 kredite</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Institucioni ofron nëpërmjet njësisë kryesore, sekretarisë dhe stafit një informacion të detajuar për programin e Bsc Fizioterapi. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; Ato pasqyrohen edhe në programe e syllabuse. Jepet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit; dhe studentët janë të qartë, për pjesmarrjen në leksione e seminare, etj. Referuar syllabuseve dhe takimit me studentët rezulton se departamenti informon studentët mbi përmbajtjen e syllabuseve dhe ndarjen e tyre në praktika, ushtrime laboratorë etj.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Universiteti ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, programet janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite. Në çdo fillim viti studentët informohen nga departamenti si dhe nga lektorët e lëndëve përkatëse për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe përbërës të tjerë të programit të studimit. Lektor i lëndës në çdo fillim semestri shpjegon në mënyrë të detajuar përmbajtjen e lëndës, sistemin e vlerësimit për atë lëndë, detyrimet akademike për t'u vlerësuar. Gjithashtu, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë çdo fillim viti jep informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara. Referuar VKM Nr.41/2018, Shtojca Nr.2, syllabuset në dosje janë sjellë pa mungesa në elementët përbërës. Ato i përmbushin të gjitha pikat e Shtojcës nr. 2 të VKM Nr 41/2018.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Me përvojën e krijuar dhe bashkëpunimin me institucione të arsimit të larte brenda e jashtë vendit, ka tashme një organizim të mësimdhënies që synon cilësinë e duhur për këtë program. Kjo është e dukshme si nga metodat që përdoren, teknologjia në dispozicion të stafit dhe studentëve, ashtu edhe nga mënyra e kontrollit të dijeve dhe aktivizimi çdo vit i studentëve në konferenca shkencore dhe aktivitete të tjera në ndihmë të cilësisë së këtij programi studimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Organizimi i mësimdhënies:

Sipas RVB dhe bashkëbisedimit me stafin akademik rezulton se, organizimet kryesore të mësimdhënies janë: leksionet, bazuar në tekstin bazë ose në literaturë bashkëkohore. Leksionet përgatiten në dy forma, Power Point, dhe Word. Lektor i përmbahet programit bazë, por ka të drejtë të shtojë tema ose materiale shtesë pa devijuar nga qëllimet kryesore të lëndës.

Format e mësimdhënies:

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, provimet e mesit të semestrit, provimet e kursit, provimi përfundimtar; të organizuara në 22 module. Numri total i veprimtarive formuese është 22 ku janë parashikuar 21 provime, dhe provimi përfundimtar.

Puna mësimore organizohet në bazë grupi dhe kursi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi, ndërsa seminarët, ushtrimet dhe diskutimet në bazë grupi. Ndarja e studentëve në grupe fiksohet në regjistrat vjetorë, të cilët janë dokumente zyrtarë, ku evidentohet zhvillimi i orëve të mësimit nga pedagogët e jashtëm ose të brendshëm dhe frekuentimin e tij nga studentët.

Regjistri i grupit është një dokument zyrtar që vërteton frekuentimin dhe që i siguron studentit të drejtën e dhënies së provimit.

Leksionet, seminarët, ushtrimet si dhe format e tjera të mësimdhënies janë të detyrueshme në masën 75% të orëve mësimore, në rast të kundërt studenti humbet të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës përkatëse në sesionin e përcaktuar nga Departamenti në strukturën e vitit akademik.

Kur frekuentimi është më pak se 50% e totalit të orëve të zhvilluara në një lëndë të caktuar, studenti e humbet të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës dhe gjatë sesioneve të provimeve të prapambetura dhe studenti duhet ta frekuentojë lëndën përkatëse para se të fitojë të drejtën të hyjë në provimin e saj.

Praktikat profesionale: Sipas kurrikulës është parashikuar që praktika mësimore të kryhet në dy pjesë: në kabinetin profesional pranë universitetit ku studentët mësojnë metodat bazë të trajtimit të pacientit në manekin ose me njëri - tjetrin. Praktika në klasë drejtohet nga pedagogë specialistë të fushës. Është projektuar të kryhet kështu pasi në këtë fazë studentët janë ende të papërgatitur në nivelin profesional për të realizuar manipulime me pacientët. Pjesa e dytë e praktikës është planifikuar të kryhet në pavijon me pacient në fazën kur studentit ka përvetësuar mbi 70 % të informacionit teorik në lidhje me trajtimin e pacientit, edhe kjo praktikë kryhet nën drejtimin e pedagogut specialist.

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (**Shiko Tabelën 11 ne aneks**):

• Leksione	775
• Seminare	334
• Ushtrime	54
• Laboratore	158
• Detyre	28
• Praktikë lëndore	250
• Praktikë profesionale	450
• TOTALI	2049

Këto të dhëna janë të Kurrikulës së re Programi Bachelor në Bsc Fizioterapi.

Format e kontrollit të njohurive (të dhëna më të detajuara jepen në **Tabela 12 në aneks**)

Kontrolli i njohurive të studentëve:

Vlerësimi i përgatitjes të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

- Provimi përfundimtar 60 pikë (60%);
- Provimi i ndërmjetëm 20 pikë;
- Pjesëmarrja, aktivizimi në seminare e laboratore 10 pikë (10%);
- Ese/prezantim/punë në grup 10 pikë (10%).

Vlerësimi i tezës së provimit është pjesë e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studentit përgjatë semestrit (seminare, testim përgjatë semestrit, ese, etj) nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës.

Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen në provim për përmirësim.

Në rastin e stazheve dhe praktikave frekuentimi është i detyrueshëm me shlyerje. Masa e frekuentimit të tyre përcaktohet nga departamenti në planin mësimor të lëndës dhe i bëhet më dije studentit para fillimit të vitit akademik.

Viti akademik është i organizuar në pesë sesione provimesh:

- në përfundim të semestrit të parë (sesioni i dimrit);
- në përfundim të semestrit të dytë (sesioni i verës);
- përpara se të fillojë viti i ri akademik (sesioni i vjeshtës).
- sesioni i provimeve të mbartura (2 sesione) sipas përcaktimit në Rregulloren e institucionit.

Për vitin e fundit të studimeve përcaktohen edhe dy sesione të veçanta:

1. Vjeshta e vogël;
2. Sesioni i diplomës.

Referuar RVB dhe takimit me përgjegjësen e departamentit rezulton se forma e provimit që departamenti vendos për çdo lëndë, përcaktohet në fillim të vitit akademik dhe i bëhet e njohur studentëve nëpërmjet plan-programit mësimor. Çdo ndryshim lidhur me formën e provimit miratohet nga departamenti dhe i bëhet e njohur studentëve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e fillimit të sesionit përkatës të provimeve.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Një formë e mire tani bërë dhe traditë është konferenca e përvitshme shkencore studentore ku marrin pjesë e referojne studentet. Po kështu edhe aktivizimi nga departamenti përkatës në aktivitete të tjera.

Detajet në shifra në Tabelë 13 në aneks.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Ne AU zbatohen me përpikmëri të gjitha vendimet dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore, të qeverise dhe MASR ne lidhje me krijimin e procedurave te pranimit të studentëve, cka pasqyrohet në dokumentacionin e kërkuar dhe krijimin e një baze të dhënash për cdo student, shprehur kjo edhe në evidentimin e vazhduar të lëvizjes së studentëve. Ka përmirësime në rezultatet e studentëve në hyrje në AU dhe bëhet kujdes në ndjekjen e mbarëvajtjes së tyre për të përfunduar në kohë e me rezultate të mira programin. Cilësia e tyre në procesin mësimor, ndiqet rregullisht nga stafi akademik, duke i testuar në mënyra të ndryshme të tilla si: në orët e seminareve, në provimet e pjesshme që realizohen në mes të semestrit dhe në provimin përfundimtar të lëndës përkatëse.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve.

Dokumentet që duhen të paraqesin studentët janë:

- Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave.
Dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit.
Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011).
- Fotokopje e kartës se identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.
- 4 fotografi
- Formulari i aplikimit

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje e studentëve:

Cilësia e studentëve në hyrje është në përgjithësi mesatare. Zbatohet Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë. Nota mesatare në hyrje 6.77 në kohën e akreditimit të parë, për këtë program, ka ardhur duke u rritur. Kështu për vitin akademik 2017-2018 mesatarja e të rregjistruarve ishte 6.99 dhe për këtë vit 2018-2019 ajo ishte 7.23. Nga të dhënat statistikore evidentojmë se brezat e viteve të ndryshme kanë ruajtur në dalje (diplomim) po të njëjtën mesatare me atë hyrëse nga shkolla e mesme.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare:

Numri i studentëve në hyrje dhe në dalje është i njëjtë .Çdo studenti i jepet mundësia të testohet në sezone të ndryshme provimesh si sezoni i dimrit, sezoni i verës, sezoni i mbartjes për semestrin e parë edhe atë të dytë dhe sezoni i vjeshtës .Të gjitha sezonet i japin mundësi studentit të rikuperojë lëndët që nuk ka mundur t'i marrë në sezonin përkatës.

Nota mesatare në hyrje 6.77 që ishte në kohën e akreditimit të parë, për këtë program, ka ardhur duke u rritur. Kështu për vitin akademik 2017-2018 numri dhe mesatarja e të rregjistruarve ishte përkatësisht 72 dhe 6.99 dhe për këtë vit 2018-2019 ishte respektivisht 80 dhe 7.23.

Tabela 14 në Aneks jep të dhëna të detajuara.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare.

Studentë të diplomuar vitin e fundit janë gjithësej 136. Nga këta 131 studentë të brezit 2015-2018. Dhe 5 studentë të brezit 2014-2018.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

AU mundeson transferimin e studenteve ne vitet brenda ciklit të parë, midis programesh të njejta ose të ngjashme, brenda institucionit apo institucione të tjera të arsimit lartë, vendase dhe të huaja. Modalitetet janë parashikuara në rregulloret përkatëse. Gjatë vitit 2017-18 janë transferuar 16 studentë, kurse 2018-2019 gjithësej 11 studentë.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Numri total të diplomuarve

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Referuar RVB, për 2017-18 janë diplomuar 136 studentë në Bachelor Fizioterapi, nga të cilët janë punsuar në profesionin e fizioterapistit vetëm 40. Të tjerët janë punësuar jo në përputhje me diplomën që kanë, 80 vetë.

Tabela 15 në Aneks jep të dhëna të detajuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Nga vizita në sekretarinë mësimore rezulton se pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Studentët per tu pranuar duhe të paraqesin pranë sekretarisë mësimore diplomën e shkolles së mesme, Id, Fotografi dhe formularin e aplikimit.
Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Nuk ka kriteret te vecanta pranimi.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikën e punësimit.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve; Studentët para çdo provimi të një lënde vlerësojnë pedagogun me pyetsor

<p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>standard anonim.</p> <p>Studentëve në cdo kohë u ofrohet këshillimi i karrierës, edhe individualisht edhe në mbledhjet e tyre dhe pranë Zyrës për Këshillimin e Karrierës,</p> <p>Ka informacion, që e kanë studentët në fushën e Fizioterapise, mbi mundësitë e punësimit si brenda dhe jashtë vendit sidomos në Evropë por jo në rrugë institucionale.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Referuar RVB por edhe viztës në Institucion rezulton se, departamenti nëpërmjet sekretarisë mësimore nxjerr të dhëna statistikore si për brezin e parë që pritet të diplomohet, ashtu edhe për vitet e brezat e ardhshëm.</p> <p>Departamenti disponon nëpërmjet sekretarisë mësimore statistikat e nevojshme për numrin e studentëve të larguar dhe të transferuar. Kryesekretaria mësimore i dorëzon statistikat përkatëse, çdo vit, në zyrën e statistikave në MASR. Sekretaria mësimore disponon të gjitha statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, për numrin e studentëve të tërhequr nga programi i studimit, për largimin dhe mospërfundimin me sukses të programit të studimit.</p> <p>Sekretaria përpunon statistikat përkatëse për notat dhe mesataret individuale dhe të programit të studimit. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Universiteti nëpërmjet sekretarisë mësimore disponon të gjitha të dhënat e nevojshme për pranimin dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në Fizioterapi. Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrimin e Diplomave. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Të dhënat statistikore i raportohen MASR dhe rektoratit.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Pranë AU, është ngritur Zyra e Karrierës. Departamenti monitoron ecurinë individuale të studentëve, ndërsa Qendra e Zhvillimit të Karrierës dhe e Këshillimit i orienton për zhvillimin e tyre profesional. AU ka të dhëna për përqindjen apo numrin e studentëve të punësuar gjatë përfundimit të programit të studimit të ciklit të parë.</p> <p>Ky proces koordinohet ndërmjet Zyrës së Karrierës dhe Departamentit përkatës. Studentët informohen për gjithçka jo vetëm nga pedagogët, fletëpalosjet, broshurat, etj por edhe nga faqja e internetit e universitetit që pasurohet vazhdimisht në funksion të mirë informimit dhe komunikimit me studentët e programit të studimit. Institucioni bashkëpunon me qendra të ndryshme spitalore e klinika për të realizuar praktikën profesionale, e cila zhvillohet në vitin e dytë dhe të tretë.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet konform ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Studentët informohen nëpërmjet Zyrës së Karrierës për të gjitha oportunitet e mëtejshme të punësimit. Universiteti arkivon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Universiteti ruan të dhëna mbi ecurinë dhe progresin e studentëve gjatë 3 viteve akademike. Studentët nga ana e tyre kanë mundësinë për të vlerësuar pedagogët e lëndës nëpërmjet pyetësorëve dhe anketimeve. Një element shumë i rëndësishëm në ndjekjen e udhëheqjen e studentëve është edhe angazhimi i pedagogëve. Institucioni ndjek progresin e studentëve në vite dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor.

Ka një bazë të dhënash për regjistrimet, hyrje e daljet dhe përsëritësit për cdo vit, në mënyrë që në cdo kohë të jepet informacion i saktë. Kjo duket nga të dhënat e tabelave të dhëna nga RVB.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Politika e AU në fushën e studimit, kërkimit shkencor është komplekse, në funksion të politikës tërësore të universitetit dhe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Veprimtaria kërkimore – shkencore e AU priret, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit nr. 80/2015, dt. “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikës së Shqipërisë”.

Botimet në vite: Universiteti, për të realizuar botimet akademike në gjuhën shqipe të autorëve akademikë vendas apo të huaj, krijon dhe ve në funksionim njësinë e botimeve akademike. Revista shkencore e universitetit “OPTIME” është mjaft e njohur jo vetëm në vend, por edhe në rajon.

Aktualisht Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë nuk ka asnjë projekt të fituar dhe të realizuar. Në vitet në vazhdim për të rritur sa më shumë cilësinë dhe profesionalizmin e tij Universitetika bërë përpjekje dhe po shqyrton mundësitë për të përfutur projekte të karaktereve të ndryshme, sipas nevojave të tregut të punës duke nxitur dhe angazhuar me tepër pedagogët e brendshëm që ai punëson.

Pedagogët nga ana e tyre kanë kontribuar me pjesëmarrje në konferenca dhe botime shkencore.

Në përputhje me organizimin e mësimdhënies Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë gjate viteve në vazhdim ka planifikuar e zhvillon konferenca studentore ,me referimin edhe të pedagogëve përkatës, dhe vetë studentëve.

Lidhja e kërkimit me mësimdhënien:

Bazuar në CV e stafit akademik rezulton se pedagogët e programit Bsc Fizioterapi kanë qenë të angazhuar në aktivitete shkencore dhe referimet e tyre kanë shërbyer si informacion edhe për studentet e vitit të parë dhe të dytë dhe të tretë.

Gjithashtu pedagogët u ofrojnë studentëve të reja shkencore të cilat i vlejné programit të lëndës dhe nuk janë pasqyruar në tekst, ose të reja të cilat mund të përmbysin një të dhënë e cila është në tekst i transmetohet studentit duke pasur parasysh nivelin e tij dhe sa do ti vlejë në të ardhmen.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor.

Numri i aktiviteteve shkencore individuale të secilit pedagog gjendet i specifikuar në tabelat në Aneks Tabela 16/a, 16/b dhe 16/c në Aneks jep të dhëna të detajuara.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

AU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar psh me Universitete te huaja, në Itali apo me Institutin e Shëndetit Publik në Shqipëri etj. Këto bashkëpunime synojnë për njohjen e ndërsjellë të kulturave, për zhvillimin kulturor, shkencor të njohurive dhe për të nxitur zhvillimin e projekteve të përbashkëta me interes të ndërsjellë etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (**Tabelat 17 ne aneks**).

Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitete te huaja, si me Universitetin e Pizës apo Aquila-s, Itali. Këto bashkëpunime janë një mjet i domosdoshëm për njohjen e ndërsjellë të kulturave, për zhvillimin kulturor, shkencor të njohurive dhe shpërndarjen e tyre, për të nxitur zhvillimin e projekteve të përbashkëta me interes të ndërsjellë në fushat e projektuara dhe disiplina të caktuara në drejtim të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Me ISHP në Shqipëri etj.

Megjithatë Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë deri tani nuk ka realizuar pjesëmarrje në programe kombëtare dhe ndërkombëtare. Sigurisht që aktivitete të tilla i shërbejnë plotësisht të gjithë procesit akademik, prandaj duhet thënë se në strategjitë afatgjata të AU duhet që ky element të marrë vëmendjen e caktuar pra pjesëmarrje në aktivitete me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë në.

Tabela 17 në Aneks jep të detajuar këtë komunikim e bashkëpunim.


Aktualisht Departamenti nuk ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me komunitetin e biznesit, ndërsa në lidhje me tregun e punës Departamenti ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me spitale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin	Brenda Universitetit ka një bashkëpunim efektiv e produktiv ndërmjet personelit akademik dhe administrativ. Secili prej tyre ka të ndara dhe të

<p>ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>qarta detyrat përkatëse; kjo gjë lehtëson bashkëpunimin në nivel institucional. Pedagogët kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. AU publikon revistën periodike, “Optime”, e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU. Po ashtu, në këtë revistë shkencore periodike përfshihen shkrime akademike edhe të bashkëpunëtorëve të AU nga Kosova, Maqedonia, Italia, etj. Universiteti disponon një strukturë organizative të detajuar. Personeli akademik dhe administrativ ka të ndara dhe të qarta rolet përkatëse, një gjë e tillë e lehtëson akoma më shumë komunikimin dhe bashkëpunimin në nivel institucional. Kjo realizohet nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve për koordinimin e saktë të mësimdhënies në ambientet e përdorur nga departamentet e ndryshëm, si dhe komunikimi i vazhdueshëm për vendimmarrje që i interesojnë të gjithë strukturës së fakultetit. Universiteti ka një strukturë të mirëorganizuar e cila bashkëpunon në mënyrë efektive.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe në rang universiteti, si Universiteti i Palermos dhe Universiteti i Pizës, sikundër po bëhen edhe përpjekje për të mbyllur marrëveshjen me Universitetin e L Aquilas.</p> <p>Universiteti ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi për realizimin e praktikës profesionale të vitit të tretë, konkretisht institucionet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Q.S.U.T; • Agjencia e Shërbimit të Sportistit; • Shtëpia e të moshuarve, Tiranë; <p>Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Nga takimi me përgjegjësen e departamentin dhe dekanin e Fakultetit rezulton se AU përpara dhe pas çdo marrëveshje bashkëpunimi realizon një analizë të përfitimeve profesionale për studentin. Konkretisht, Departamenti e përzgjedhi QSUT dhe Spitalin e Traumës, për vet faktin se në të ndodhen një larmi repartesh në të cilat studenti mund të shohë praktika dhe ndërhyrje të ndryshme, për të cilat i ka marrë njohuritë respektive në lëndët e ndryshme që ka zhvilluar në dy vitet e para të studimit, gjithashtu edhe në manipulimet e ndryshme të realizuara në praktikën në klasë në vitin e dytë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Departamenti ka një lidhje të vazhdueshme me të gjithë stafin akademik të angazhuar në procesin mësimor. Pedagogët kanë kryer studime të cilat i kanë prezantuar në konferencat brenda dhe jashtë vendit. Departamenti organizon konferenca shkencore. Në vazhdim të mbështetjes së kërkimit shkencor Universiteti nëpërmjet revistës shkencore “Optime” i mundëson stafit akademik të botojnë artikujt e tyre shkencorë. Universiteti nuk angazhohet drejtpërsëdrejti në kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik, por e mbështet atë në çdo nevojë shkencore dhe akademike për ta zhvilluar më tej atë. Po ashtu AU nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj, por ka ofruar lëndë dhe leksione të veçanta në gjuhë të huaj në programet Bsc, të mbajtura nga pedagogë të huaj.</p> <p>Në këto tre vite të programit në fjalë konstatohet se Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme</p>	

bashkëpunimi me partnerët e huaj e vendas.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E KONSTATIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a. Për konstatimin a: institucioni ka plotësuar gradualisht stafin e departamentit me pedagogë specialist të fushës fizioterapisë me tituj e grada shkencore. **Plotësuar plotësisht**
- b. Për konstatimin b: institucioni ka ardhur në nivelin e duhur në raportet PAE/PAK. **Plotësuar plotësisht**
- c. Për konstatimin c: institucioni ka plotësuar në vazhdimsi stafin ndihmës mësimor e administrativ. **Plotësuar plotësisht**
- d. Për konstatimin d: pasurimi me tituj të rinj i Bibliotekës dhe specifikisht për fushën e fizioterapisë është plotësuar. **Plotësuar plotësisht**
- e. Për konstatimin e: mesatarja e studentëve të rekrutuar ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. **Plotësuar kryesisht**
- f. Për konstatimin f: akoma ceshtje e kërkimit shkencor bëhet me hapa të ngadalshme. **Plotësuar pjesërisht**
- g. Për konstatimin g: ka ndryshime në moshën mesatare të stafit me tituj/grada shkencore. **Plotësuar plotësisht**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Një kurrikul bazuar në standardet e duhura për formimin sa më profesional të studentit, kurrikul e njësuar me procesin e Bolonjës.
2. Staf akademik aktual i përkushtuar dhe specializuar, drejtuar nga njerëz me eksperiencë, tituj e grada shkencore.
3. Bashkëpunime me qendra spitalore e klinika fizioterapie për realizimin e praktikës profesionale.
4. Pajisja me mjetet e nevojshme për realizimin e praktikës mësimore, në vitin e dytë në auditorin (kabinetin e fizioterapisë së AU), posedimi i aparaturës më moderne të kohës.
5. Sigurohet për fizioterapi një diplome, që ka vlerë në tregun e punës, si profesion i rregulluar me ligj.
6. Bibliotekë me tituj tashme të Fizioterapisë bashkëkohore.

b. Pika të dobëta:

1. Shfrytëzimi i ulët i literaturës së huaj nga libraritë on line në dispozicion të studentëve.
2. Puna kërkimore shkencore vazhdon të jete jo e bazuar në projekte të njesive apo institucionale, në nivele kombetare apo nderkombetare. Ajo kryhet individualisht nga stafi akademik në shërbim gradave e titujve akademikë.

3. Pjesmarrja e stafit akademik ne trajnime, kualifikime shkencore, sidomos jashtë vendit është e ulët.

c. Mundësitë:


1. Rekrutimi i pedagogëve të rinj te kualifikuar, me tituj e grada shkencore specialistë fizioterapie.
2. Fitimi tashmë i një eksperience në arsimin e lartë.
3. Rritja e numrit të studentëve duke patur parasysh nevojat e tregut, që akoma janë të shumta në këtë fushë.
4. Administrimi efikas i burimeve që rrjedhin nga marrveshjet me universitete partnere apo biznesi të huaja e vendase.
5. Promovimi i një Qendre Rehabilitimi Universitare për të tretë.

d. Pengesat:

1. Gjendja e sotme ekonomike e financiare kudo në Evropë dhe në vendin tonë mund të ndikojë në afrimin e studentëve (qoftë në këndvështrimin financiar edhe në atë cilësor).
2. Tashmë janë hapur edhe kurse të tjera private e publike në fizioterapi. Konkurrenca me to është faktor ndikues në ecurinë e programit të Bsc fizioterapisë në AU.
3. Mungesa e financimit për kërkimin shkencor.
4. Periudhë e shkurtër nga fillimi i programit cka pengon ndërmarrjen e projekteve të kërkimit shkencor.

Rekomandime:

1. Shtimi i zërave të periodikëve të literaturës së huaj, për këtë program, në librarinë on line në dispozicion të studentëve.
2. Puna kerkimore shkencore të ngrihet mbi bazën e projekte te njesive apo institucionale, ne bashkëpunim edhe me institucione të tjera kombetare apo nderkombetare (universitetet Italiane).
3. Mbështetje financiare nga AU për pjesmarrje të stafit akademik ne trajnime, kualifikime shkencore, sidomos jashte vendit .
4. Në mungesë të një kampusi me terrene rekreative sportive të hapura e mjedise të tjera në shërbim të gjallërisë e cilësisë së jetës studentore të shikohet mundësia për tua ofruar këtë studentëve, qoftë edhe duke u financuar nga universiteti në mjedise të tilla, si palestra, fusha lojrash,etj .
5. Permirësimi i cilësisë i shërbimit i klinikës së fizioterapie për pacientët e jashtëm, gje qe do te permirsonte ndjeshme cilesine e praktikave te studenteve duke rritur reputacionin, vevetleresimin dhe edhe si nje burim te ardhurash për universitetin.
6. Promocion më i fuqishëm dhe financim (bursa) për të afruar ne programin e studimit studentë me mesatare te larte .



SUMMARY ANALYSES OF THE STUDY PROGRAM EVALUATION

I. ANALYSIS OF ASCERTAINS FULFILLMENT FROM THE PREVIOUS ACCREDITATION.

- a. Ascertain a: the institution has gradually completed the department with specialist lecturers in the field of physiotherapy with titles and degrees. **Fully Completed.**
- b. Ascertain b: EAP / CAP reports are now in the right level. **Fully Completed.**
- c. Ascertain c: the institution has continuously complemented the teaching and administrative support staff. **Fully Completed.**
- d. Ascertain d: the institution has enriched the Library with new titles specifically for the field of physiotherapy. **Fully Completed.**
- e. Ascertain e: the average grade of students recruited has increased year by year. **Substantially Completed.**
- f. Ascertain f: scientific research is still progressing slowly. **Partially Completed.**
- g. Ascertain g: there are changes in the average age of staff with scientific titles / degrees. **Fully Completed.**

II. SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION GROUP BY SWOT METHOD (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

a. Strengths:


1. A curriculum based on the apt standards for the outmost professional development of the students, the curriculum aligned with the Bologna process.
2. Dedicated and specialized academic staff, led by experienced people, holding academic titles and degrees.
3. Collaborating with hospitals and physiotherapy clinics for the professional practice.
4. Being equipped with the necessary tools for the delivery of the professional practices, in the second year in the auditorium (physiotherapy room), possession of the latest equipment.
5. It provides a diploma of physiotherapy, valuable in the current labour market, being a profession regulated by law.
6. A library rich in contemporary Physiotherapy editions/titles.

b. Weaknesses:

1. Exploitation of online literature available for the students is at a low level.
2. Research work is not based on department or institutional projects of national or international levels. It is performed individually by the academic staff in the perspective of achieving the required academic degrees.
3. The participation of academic staff in training and qualification courses, especially abroad remains low.

c. Opportunities:

1. Recruiting new qualified lecturers, with academic and research titles and degrees in the field of physiotherapy.
2. It has already gained experience in higher education.



3. Increasing the number of students considering the market needs, which are still numerous in this specific field.
4. Effective management of resources arising from agreements with foreign and domestic partner universities or businesses.
5. Promotion of a University Rehabilitation Centre for third parties.

d. Threats:

1. Today's economic and financial situation all around Europe as well as in our country can affect students' approach (both in the financial and quality aspect).
2. Other private and public physiotherapy courses have already been opened. Thus, competition is an influential factor for the progress of the Bachelor study program in physiotherapy at AU.
3. Lack of funding for scientific research.
4. The short period since the commence of the study program which impedes the undertaking of research projects.

Recommendations:

1. Enriching the online library with foreign periodicals relevant with this program.
2. Research work should be organized based on department or institutional projects as well as in collaboration with other national or international institutions (Italian universities).
3. Financial support by AU to enable participation of academic staff in training and qualifications especially abroad.
4. In the absence of a campus with the specific university facilities and premises, open recreational grounds and other facilities to enliven and make more qualitative student life, it should be considered the possibility of providing these to students, possibly by means of funds by the university in facilities such as gyms and sports or recreational grounds, etc.
5. Improving the service quality of the outpatient physiotherapy clinic, which would significantly improve the quality of student practices by enhancing reputation, self-esteem and which could serve a source of income for the university.
6. Stronger promotion and funding (scholarships) to attract students who have higher average grades.

External Evaluation Group

Prof. Dhimitraq Stratobërdha

Prof Asoc. Irena Saço Kola.